

VENDIM
Nr.66, datë 28.1.2005

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Gjirokastrës, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona të shërbimit të kullimit të këtij bordi janë:

2.1 Zona e fushës së Dropullit (GjK-1, GjK), që kullon sipërfaqen prej 5600 ha-sh;

2.2 Zona e fushës së Gjirokastrës, Vlaresë (GjK-2), që kullon sipërfaqen prej 1750 ha-sh;

2.3 Zona e fushës së Lunxhërisë, Odrijës, (GjK-4), që kullon sipërfaqen prej 1000 ha-s;

2.4 Zona e fushës Cepunë-Mashkullorë, Humelicë, Kardhiq (GjK-5, GjK-6, GjK-7), që kullon sipërfaqen prej 1100 ha-sh;

2.5 Zona e fushës së lumit Vjosë (PRK-1), që kullon sipërfaqen prej 2500 ha-sh;

2.6 Zona e fushës së luginës së lumit Dëshnicë-Këlcyrë-Ballaban (PRK-2), që kullon sipërfaqen prej 600 ha-sh;

2.7 Zona e fushës së luginës së Vjosës, Dragot-Kalivac-Krahës (TPK-1), që kullon sipërfaqen prej 1500 ha-sh;

2.8 Pendët mbrojtëse nga përmytjet e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;

2.9 Veprat mbrojtëse nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, brenda fushave të sistemuara.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

b) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 1 (një) përfaqësues i qarkut;

d) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit;

dh) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të bordit të shpërblehen çdo muaj me nga 5000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano